



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.128/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Anita Peci duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Klinë, për shkak të vendosjes së posterëve në objekte publike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Klinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 500 (pesëqindtë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se me datën 05.10.2017, zyrtarë të tyre kanë fotografuar poster të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Klinës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të vendosur në shtylla elektrike, përgjatë magjistrales Klinë-Gjakovë, saktësisht në rrugën prej Gremnikut deri te rruga e Volljakut.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LZP-së, të dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur 5 (pesë) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2017 Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka potencuar se posa është njoftuar nga PZAP-i në lidhje me ankesën, ka njoftuar Shtabin Zgjedhorë në Klinë për të ndërmarrë masat përmirësuese, ashtu që ti largojë menjëherë të gjitha materialet për të cilat është urdhëruar nga PZAP-i të largohen nga vendi i palejuar. Më tej kanë shtuar se posterët janë vendosur nga disa simpatizant të cilët nuk kanë pasur njohuri se po bëjnë shkelje. Po ashtu në përgjigje thuhet se LVV ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj për dispozitat e Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nevojat për të zbatuar ato.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy video-incizime ku shihet heqja e posterëve nga shtyllat elektrike.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterë të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik LVV, janë vendosur në objekte publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LVV, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterë të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik LVV, janë vendosur në objekte publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posterë të kandidatëve të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në objekte publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterët nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL.Anr.128/2017 me datën 10.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Zyhdi Haziri

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***